



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 8 korrik 2013
Nr. Ref.:RK444/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI62/13

Parashtruesi

Tahir Morina

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme në
Prishtinë Rev. nr. 49/2010 të 01 shkurtit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përberë nga:

Enver Hasani, Kryetar,
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Tahir Morina, nga fshati Gllabar, (në tekstin e mëtejme: Parashtrues i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati Xhafer Maloku nga Klina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme në Prishtinë Rev.nr. 49/2010 i 01 shkurtit 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës të parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të 23 prillit 2013, është konfirmimi i të drejtave pronësore në pronën, e cila është objekt i kontratës së lidhur më 21 nëntor 2002.

Baza ligjore

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 i 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës së 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 23 prill 2013, Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, dhe e njëjta është regjistruar me numër KI62/13.
6. Me Vendim të Kryetarit, Gjyqtari Kadri Kryeziu caktohet Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues, Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
7. Më 25 qershor 2013, Kolegji Shqyrtues pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit Raportues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Më 21 nëntor 2002, Parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e blerësit lidhi kontratën e shitblerjes me V.R., i cili në kontratë është shënuar si shitës i patundshmërisë, të cilin sipas autorizimit Vr.nr. 3842/2002, të 18 nëntorit 2002, i cili është i vërtetuar në Gjykatën Themelore në Ulqin (Republika e Malit të Zi), e përfaqëson B. M.
9. Sipas kontratës, parashtruesi e fiton të drejtën e pronësisë në pronën e shitësit dhe kjo në paluajtshmërinë e cila në fletën poseduese është regjistruar me

numër 791, si ngastra kadastrale nr. 533 ZK Klinë, si dhe të drejtën e transferimit të pronësisë në emër të vet.

10. Të njëjtën ditë, Parashtruesi i kërkesës ia paguan shitësit V.R. çmimin e kontraktuar, në shumë prej 200.000,00 eurosh, dhe në të njëjtën kohë në Drejtorinë për Kadastër në Klinë e regjistron paluajtshmërinë, cila është objekt i kontratës, në emrin e tij.
11. V.R. e konteston vlefshmërinë e kontratës së lidhur më 21 nëntor 2002, dhe në një ditë të paspecifikuar parashtron kërkesën për kthimin e pronës Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: KKPb).
12. Gjithashtu, në një datë të paspecifikuar V.R., inicon procedurë penale në Gjykatën Themelore në Ulqin, për shkak të mashtrimit, si dhe padinë civile në Gjykatën Komunale në Klinë, me qëllim të kthimit të pronës së poseduar.

Procedura në KKPb

13. Më 18 qershor 2005, KKPb-ja në procedurën e shkallës së parë, bazuar në shkresat e lëndës në dispozicion dhe mendimin e grafologut për vërtetësinë e nënshkrimit, me të cilin është nënshkruar autorizimi Vr.nr. 3842/2002 i 18 nëntorit 2002, dhe kontratës së shitblerjes, e cila është nënshkruar më 21 nëntorit 2002, lëshon urdhrin që personit V.R. ti kthehet prona, dhe njëkohësisht të dëbohet pala tjetër (Parashtruesi).
14. Më 31 tetor 2005, Parashtruesi ushtron ankesë në afatën ligjor kundër vendimit të shkallës së parë të KKPb të 18 qershorit 2005.
15. Më 08 qershor 2007, në procedurën e shkallës së dytë, sipas ankesës së Parashtruesit, KKPb-ja nxjerr vendimin që të refuzohet kërkesa e Parashtruesit për shqyrtimin e sërishëm të vendimit të shkallës së parë të 18 qershorit 2005, dhe të lëshohet urdhri përfundimtar si ai i mëparshëm.

Procedura penale në Gjykatën Themelore në Ulqin (Republika e Malit të Zi)

16. Më 17 prill 2007, Prokuroria Themelore Shtetërore në Ulqin ngrit aktakuzën në Gjykatën Themelore në Ulqin kundër të pandehurve, Parashtruesit të kërkesës dhe M.B., nga Gllogovci, qytetar i Republikës së Kosovës, për shkak të veprës penale nga neni 207 para. 3. në lidhje me para. 1. ZK RMZ (falsifikim i dokumenteve), dhe veprës penale nga neni 209, para 1. ZK RMZ (Nxitje në vërtetimin e përmbajtjes së pavërtetë).
17. Më 09 shkurt 2012, Gjykata Themelore në Ulqin nxjerr Aktgjykimin K. nr. 185/08. Në dispozitiv të aktgjykimit, Gjykata konstaton se, *"gjatë prezantimit të provave dhe dëgjimit të dëshmitarëve si dhe mendimit të ekspertit gjyqësor grafologut është konstatuar se dokumenti personal në emër të V.R., me numër 31854, lëshuar nga SPB- Klinë, i cili me rastin e vërtetimit të autorizimit në Gjykatën Themelore në Ulqin është shfrytëzuar si i vërtetë, paraqet dokument publik të rrejtshëm, se i njëjti nuk është lëshuar nga SPB Klinë, që është*

vërtetuar nga shkresa e MPB e Republikës së Serbisë nr. 205-325/11 të 13 prillit 2011. Gjykata e ka vlerësuar këtë provë si të besueshme, sepse i njëjti është lëshuar nga organi kompetent, i cili ka vërtetuar se leja e njoftimit me numrin serik CP61221811, numri i regjistrimit 31854, nuk është autentik dhe nuk është lëshuar nga ana e SPB Klinë me emër të V.R.“

18. Gjykata gjithashtu thekson: *“se është vërtetuar në mënyrë të padryshimtë se personi, i cili më 18. nëntor 2002, në Gjykatën Themelore në Ulqin e ka vërtetuar autorizimin në emër të V.R., ka shfrytëzuar dokumentin personal të rrejshëm me numër të regjistrimit 31854, të cilin Gjykata e ka konstatuar me librin e vërtetimeve, por që në procedurë nuk është vërtetuar se ky person ishte parashtruesi i kërkesës ose M.T.“*
19. Sipas kësaj, Gjykata Themelore në Ulqin me aktgjykimin [K.nr.185/08] të 09 shkurtit 2012, i liron të pandehurit, Parashtruesin e kërkesës dhe M.B., nga aktakuza, sepse nuk është dëshmuar se ata e kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, ndërsa të dëmtuarit V.R., Gjykata i sugjeron që ta realizojë kërkesën e tij pronësore-juridike në procedurën kontestimore.
20. Më 05 korrik 2012, Gjykata e Lartë në Podgoricë, sipas ankesës së Prokurorisë Themelore shtetërore në Ulqin kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ulqin [K.nr 185/2008] të 09 shkurtit 2012, e nxjerr Aktgjykimin [Kz nr.1027/2012], me të cilin refuzohet ankesa e prokurorisë dhe vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore [K.nr 185/2008] në Ulqin e 09 shkurtit 2012.

Procedura lidhur me anulimin e kontratës së shitblerjes [1478/2002] në Gjykatën Komunale në Klinë

21. Më 02 prill 2009, Gjykata Komunale në Klinë me Aktgjykimin [C.nr 48/2004], e anulon dhe e shpall të pavlefshëm kontratën e shitblerjes numër 1478/2002 të 21 nëntorit 2002, në të cilën si palë kontraktuese janë paraqitur Parashtruesi dhe V.R.
22. Gjykata në dispozitiv të aktgjykimit thekson se *“i padituri (Parashtruesi) të heqë dorë nga posedimi dhe të largohet nga paluajtshmëria, e cila në listën poseduese është regjistruar me numër 791 si ngastra kadastrale nr. 533 ZK Klinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.“*
23. Gjykata gjithashtu e ka urdhëruar zyrën kadastrale të Komunës së Klinës që ti bëjë ndryshimet në librat kadastrale në pajtim me aktgjykimin dhe regjistrimin e ngastrës në emrin e paditësit, respektivisht V.R.
24. Parashtruesi i kërkesës në një ditë të paspecifikuar kishte ushtruar ankesë kundër Gjykatës Komunale në Klinë (ankesa e Parashtruesit nuk ekziston në shkresat e lëndës, por, si bazë për paragrafin 23 janë shfrytëzuar thëniet nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme).
25. Në një ditë të paspecifikuar, Gjykata e shkallës së dytë e hedh poshtë ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi aktgjykimin e shkallës së parë (aktgjykimi i shkallës

së dytë nuk ekziston në shkresat e lëndës, por si bazë për paragrafin 24 janë shfrytëzuar thëniet nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme).

26. Më 19 mars 2013, parashtruesi kishte parashtruar kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme.
27. Më 01 shkurt 2013, Gjykata Supreme nxjerr aktgjykimin [Rev. nr. 49/2010], me të cilin refuzohet revizioni i Parashtruesit të kërkesës si i pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij nga neni 31 i Kushtetutës (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) në lidhje me nenin 358, para. 5 362-370, dhe posaçërisht të nenit 371 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK)
29. Parashtruesi gjithashtu pretendon se *„nuk dihet kush e ka bërë ekspertizën grafologjike ne procedurën para KKPB-në, por thuhet se është bërë te një grafolog privat në Bullgari. Nuk është bërë sipas praktikës gjyqësore ku do të aplikoheshin kushtet për përgjigje në pyetjet interaktive të palëve të interesuara, por është bërë në një mënyrë tjetër që nuk i plotëson kushtet dhe standardet e një ekspertize gjyqësore, sipas kriterëve të nenit 371 të KPK.“*
30. Parashtruesi pretendon se ai nuk kishte marrë pjesë personalisht në procedurën në KKPB si pronar i vërtetë dhe as nuk e kishte autorizuar një person tjetër për ta përfaqësuar atë ne procedurën për vërtetimin e pronësisë para KKP-së.
31. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesën vijuese:

“Që Gjykata të konstatojë se në procedurat para gjykatave të rregullta, palës së paditur (Parashtruesit) iu kanë shkelur këto të drejta kushtetuese:

- a) Barazia para ligjit – neni 24 i Kushtetutës, sepse parashtruesit nuk i është dhënë mundësia të merr pjesë në një procedurë para KKPB-së, në të cilën është shqyrtuar për pronën e tij. Se të gjitha provat janë përdorur kundër tij, dhe se procedura e ka favorizuar kundërshtarin e tij V.R.*
- b) E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm – neni 31 i Kushtetutës, sepse prova kyçe (ekspertiza e grafologut) është nxjerrë në mënyrë joprofesionale në një procedurë që nuk është gjyqësore.“*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

32. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregulloren e punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton se:

„Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.“

34. Edhe pse parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se me vendimet e gjykatave të rregullta dhe me vendimin e KKPb-së i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe ligje të Republikës së Kosovës, ai nuk ka dorëzuar asnjë provë relevante ose fakt që do të dëshmonte se Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore ose organet gjyqësore kanë shkelur ndonjë të drejtë të tij të garantuar me Kushtetutë (*shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, vendimi i KEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99 të 31 majit 2005*).

35. Gjykata vlerëson se në bazë të nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 parashihet se Komisioni (KKPB) ka juridiksion për vendosje:

„Kërkesat e personave fizikë të cilët kanë qenë pronarë, posedues ose që kanë pasur të drejtën e banimit në pronën banesore para datës 24 Mars 1999, e që tani nuk kanë atë pronë në posedim, dhe kur e drejta e pronësisë nuk është transferuar vullnetarisht.“

36. Ky juridiksion është sqaruar në Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60, si në vijim:

“2.5 Çdo refugjat ose person i zhvendosur, me të drejtë mbi pronën, gëzon të drejtën e kthimit të pronës ose të disponojë me të në pajtim me ligjin dhe në përputhje me këtë rregullore.

2.6 Çdo person me të drejtë në pronë më 24 mars 1999, i cili e ka humbur posedimin në atë pronë dhe nuk ka hequr dorë vullnetarisht nga e drejta në pronë, ka të drejtë të marrë vendim nga Komisioni për ri-posedim të pronës. Komisioni nuk do të pranojë kërkesa për kompensimin e dëmtimeve apo të shkatërrimeve të pronës....“

37. Përkitazi me rastin konkret, Gjykata rikujton se me çështjen e vendimeve të KKPb-së është marrur në rastin KI 104/20, dhe se me 29 prill 2012 ka nxjerrë Aktgjykimin AGJ221/12, ku theksohet: *“Gjykata është e mendimit se Vendimi i KKPb-së i datës 15 korrik 2006 duhet konsideruar si vendim i formës së prerë dhe që është bërë res judicata me rastin e certifikimit nga ana e sekretarit të KKPb-së më 4 shtator 2006, siç konfirmohet me Letrën e Konfirmimit të KKPb-së të 7 majit 2008 drejtuar parashtruesit të kërkesës. Në këtë letër po ashtu, thuhej se procedura në lidhje me kërkesën e parashtruesit i ishte bartur Drejtorisë së Çështjeve Pronësore Banesore në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe se kishte përfunduar, ndërsa mjetet juridike në dispozicion të palëve në bazë të dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 ishin shterur.”*

38. Gjykata Kushtetuese përkujton se nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë apeli në kuptimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat gjegjëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*shih, mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër*

Spanjës [VK] nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [ECHR] 1999-1).

39. Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë prezantuar në mënyrë të duhur, si dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në atë mënyrë që Parashtruesi të ketë gjykim të drejtë (*shih, mes burimeve tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Parashtrësia Nr. 13071/87 miratuar me 10 korrik 1991*).
40. Megjithatë, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Parashtruesi, Gjykata Kushtetuese nuk gjen që procedurat e KKPB-së dhe të gjykatave të rregullta ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (*shih, mutatis mutandis, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës, nr. 53363/99, të 31 majit 2005*).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) të Rregullores së Punës, më 8 korrik 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Dr. sc. Kadri Kryeziu



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani